



QAFS  
(Qarku Aktiviteteve Formative Saleziane)

# ***Dënime? Po, faleminderit!***



## Pedagogji si tul buke?

### Jo, faleminderit!

Ndoshta jo të gjithë e kuptojnë, por është duke qarkulluar një ambient revizionimi të edukimit si tul buke.

Tashmë ne dimë mjaftueshëm për të ditur çfarë frytesh sjell kjo metodë.

Një nga peiadrat amerikanë, T. Berry Brazelton është shumë i qartë: “Çfarëdo moshe të ketë fëmija juaj, i bëni një të mirë të madhe dhe i demonstroi sa e doni atëherë kur i impononi rregulla disiplinore. Një fëmijë i përkëdhelur nuk është një fëmijë i lumtur. Është vetëm një fëmijë që kalon nga një eksperiencë në tjetrën.

Prandaj nuk duhet të keni ndjenjë faji. Disiplina juaj nuk është shenjë dënimi, por një shenjë mirësie”.

Psikologja Jacqueline Renaud është akoma më konkrete.

Tregon: “Një fëmijë 5 vjeç, që erdhi në studion time më tha: “Babai nuk më do. Unë e pyeta: “Përse nuk të do?” I vogli mu përgjigj: “Sepse nuk më bërtet kurrë”.

Pra: fëmijët ndoshta kuptojnë që familja duhet të jetë hierarkike! Jo, nuk bëhet fjalë të jenë autoritarë, negativë, nuk bëhet fjalë për stil të mbyllur, bëhet fjalë për edukimin e një fëmije.

Tani, ‘të edukosh’ është: të folurit, të dashurit, të urdhëruarit, të gëzimit..., ndonjëherë është edhe ‘të dënuarit’.

Ja fjala antipatike që, ndoshta, duhet që dalë sërisht nga fjalori dhe vihet në qarkullim.

Shumë mirë!

Pse të dënosh nuk të vuash, nuk është të dënosh, nuk është të mëshirosh: të dënosh është lajmërimi që fëmija është duke gabuar!

Dënimi pedagogjik nuk ka karakter ndëshkues, por orientues: dëshiron të të çojë në rrugë të drejtë kush ka dalë nga rruga.

“Fjalë të bukura!”, do të thotë.

Është e vërtetë: Dënimi nuk është një sport i lehtë! Të dënosh kërkon inteligjencë dhe forcë.

Ja përse kërkimet thonë që prindërit që dënojnë më pak (ose kurrë), nuk janë ata më bujarët dhe më të ndjeshmit por më dembelët!

Bëhet fjalë, në fakt, të zbatosh një sjellje që të mos jetë autoritare, as tolerante, as e ashpër, as toleruese.

Një ekuilibër i vështirë për tu arritur.

Ndonjëherë mund të gabosh.

Që, sipas nesh, ka gabuar, për shembull, një mësues që ka dënuar një nxënës 7 vjeç duke e detyruar të qëndrojë për 6 muaj në bankë përballë murit, si dënim për zënkën që ka bërë me shokun e tij. (Dënimi nuk është i pranueshëm sepse izolimi është gjithmonë varfërim! Zgjedhja e një tipi tjetër dënimi – i nevojshëm në këtë moment! – do të ishte më i përshtatshëm).

Si përfundim: ‘të dënosh’ është një art për t’u mësuar.

Megjithatë është mirë të flasim rreth tij.

Ndërkohë do të shohim pse dënimi është një strategji edukuese jo më pak e rëndësishme sesa shumë të tjera.

Paraqesim hartën e tipave të ndryshme të dënimeve.

Përfundojmë duke thënë si të dënojmë që korrigjimi të jetë nga ana pedagogjike korrekte.



# Shumë

## Shumë arsye

Arsyet që justifikojnë praninë e dënimit në artin e edukimit janë më shumë se një.  
Kemi identifikuar 5 prej tyre!

**1** Ndërkohë dënimi është i lejuar nëse lajmëron fëmijën, të riun, që jo gjithçka është e ligjshme, jo gjithçka është e lejuar.  
Ka kufij në sjellje.  
Nuk është e ligjshme të godasësh shokun, nuk është e ligjshme të marrësh gjërat e të tjerëve, nuk është e ligjshme të shkulësh lulet, nuk mund të kalojmë rrugën me vrap...  
Fëmija që i thyen këto rregulla duhet t'i kuptojë qartë ato!  
Dënimi shërben pikërisht për këtë: për ta bërë të ndërgjegjshëm për këtë sjellje jo të ligjshme.  
Ta lësh të ikë është gabim!  
Metodat *tul buke* nuk edukojnë!  
Prindërit që nuk ndërhyjnë kurrë përgatisin një fëmijë plot ankth, i papërqendruar, një fëmijë të papërmbytur, mendjemadh, egocentrik dhe, ndoshta, nesër kriminel!  
Po, sepse një fëmijë i mësuar me mosndëshkimin total është një kandidat i prepotencës, i tiranisë.

**2** Dënimi është i justifikuar, pastaj, se fëmijët, veçanërisht djemtë, kanë nevojë të besojnë në ne.  
Psikologjia Anna Oliverio Ferraris: “Sa më të vegjël janë, më shumë fëmijët kanë nevojë të ndjejnë që të rriturit kanë kontrollin e situatës. Pra do t'i ndihmojë të rriten më të sigurt!”.  
Shumë pranë Ferraris është Jacqueline Armand, e cila nënvizon që dënimi është shenjë ndaluese. Tani “Avantazhet e ndalimit për të rinjtë, nuk kanë nevojë të demonstrohen. Ndalimi favorizon ndërtimin e një personaliteti”.

***“Vetëm kush të do ka të drejtën e dënimit”.  
Fëmija dënohet kur e meriton, jo kur ne jemi nervozë.***

**3** Dënimi është i justifikuar, nëse është shenjë e vëmendjes ndaj fëmijës.  
Të gjithë e dinë që gjëja më e padurueshme nga fëmijët është: Indiferenca.  
Indiferenca është “*kafsha e zezë*” e fëmijërisë!  
Po, fëmija preferon dënimin më mirë se mospërfilljen!  
Përkundrazi, është ai vetë që pret dënimin pas gabimit!  
Ja: ky është konteksti i mirë për t'i bërë të ditur që gabojnë ata prindër që frikësohen që dënimi bën të largojë dashurinë e fëmijës.  
Jo, është gjithçka në rregull!  
Prindi që dënon rrit vlerësimin e fëmijës përballë tij, jo vetëm t'i japë qetësi dhe siguri!

Prindërit që dënojnë, duan. Biri/bija, edhe fëmijë, e gjen dhe kështu lidhet akoma më shumë me babain dhe mamanë.

***“Fëmija duhet të dijë se kush janë limitet që nuk duhet të kapërcejë” (Fernando Savater, filozof spanjoll)***

**4**

Dënimet janë të vlefshme sepse forcojnë vullnetin.

Dënimet krijojnë antikorpe të nevojshme për të qëndruar në këmbë edhe kur jeta është e vështirë.

Psikiatri Paolo Crepet thotë: “Një prind duhet të dijë t’i thotë jo fëmijës, nëse ia do të mirën, përndryshe me “bëj ç’të duash rrezikohet largimi i antitrapave të nevojshme psikologjike”.

Në të njëjtën linjë të psikiatrit është edhe shkrimtari Massimo Gramellini: “Duke ia bërë rrugën shesh fëmijës, rrezikohjmë ta ekspozojmë ndaj goditjeve emocionale rezultati i të cilave është të shumtën e herëve depresioni”.

**5**

Më në fund dënimi është një justifikim sepse, në disa raste, është rruga më e shpejtë dhe e sigurt për të evituar pasojat të pakëndëshme dhe të rënda.

Fëmijët nuk janë engjëj, ndonjëherë janë edhe të papërmbyjtshëm: janë gjëra që i dimë të gjithë!

Në këto raste një dënim mund të jetë i nevojshëm (i domosdoshëm).

I vogli është duke luajtur: për një moment godet me shkelma jo vetëm topin, por edhe shokun dhe eshtyn. Në këtë rast duhet dënimi i menjëhershëm: fëmija duhet të dalë nga fusha e lojes!

Zihet me motrën? E ndajmë dhe i japim një shpullë në të ndenjura!

Hedh gurë sa majtas, sa djathtas? I ndalojmë krahun!

Vë gishtin në prizën e korrentit, gati bie nga ballkoni ndërhyjmë me një dënim!

Në këto raste duhet që dënimet, edhe pse energjike, janë me të vërtetë me vend (të nevojshme, të shkurtra, pa pasoja të tjera jo të dhimbshme por energjike)

Përfundimi: prania e dënimeve në edukimin është legjitime!

Kaq legjitime sa edukatorët nuk e kanë vënë kurrë në dyshim vlefshmërinë; vetëm kanë diskutuar për tipin e dënimit që kemi në dispozicion dhe si mund t’i përdorim.

Edhe ne, marrim pjesë në diskutime të tilla

***“Është prindi shumë i dobët, që të çon tek forca”.***



# Harta e dënimeve

Nuk është e vështirë të ndërtojme tabelën e dënimeve. Ja tipet kryesore

## **Dënime trupore**

Shuplaka, fasule ose kokrra gruri poshtë gjunjëve (*kuriozitet: Benito Mussolini, që fëmijë, shumë herë ka marrë dënime të tilla, në shkollë, për shqetësimet e tij*).

Çfarë mund të thuash për dënime të ngjashme?

## **Janë dënime për t'u mospraktikuar**

➤ Sepse të ndaluar nga ligji pothuajse nga të gjitha shtetet. Një rast që ka shkaktuar një ndjesi: në 2011 një baba italian, banues në Svicër dënohet me 750 euro gjobë dhe tre ditë burg sepse ka ngritur nga flokët vajzën kapriçioze, gjatë një dreke në piceri.

Larg, d.m.th. dënimeve trupore!

➤ Jo vetëm sepse janë të ndaluar me ligj, por (nga pikëpamja jonë) shumë e më shumë sepse kanë efekte të rënda tek i vogli: i provokojnë pakënaqësi, përulën, lënë gjurmë të ankthit dhe frikës.

➤ Larg, sepse dënime të tilla nuk eliminonjë çështjen e së keqes. Një goditje duarve, p.sh. mund të shërbejë për të ndaluar fëmijën për të mos vazhduar gabimin, por mund të çojë në një sjellje tjetër: të godasë macen, masturbim, të godasë motrën...

➤ Larg, akoma, sepse keqtrajtimet fizike bëjnë që të jetë joshinqëror dhe arrogant atë që keqtrajtohet. Kush është goditur që i vogël, do të godasë të tjerët kur të jetë i madh, siç ndodh në kazermame “nonizmin”. Edhe pse u zgjatëm, është e nevojshme sepse ndonjë nga metodat e edukimit janë akoma edhe sot: keqtrajtimet e fëmijërisë, janë gjithçka tjetër se të humbur!

## **Por, si duhet të sillemi?**

Për ta thënë shkurt: është çështje ekuilibri! Nuk mund të formulohen rregulla absolute.

Por dy gjëra janë të qarta.

*E para:* dënimi trupor nuk lë shenja negative nëse është futur në një kontekst global pozitiv të të kuptuarit dhe shfaqjes konstante të dashurisë prindërore.

Në këto raste, e njëjta shuplakë shikohet nga fëmija gati gati si një provë dashurie, një veprim faljeje më shumë se dënim.

*E dyta:* gjëja më e qartë është që dënimi trupor e përdorur si metodë nuk edukon njeri.

Mund të jetë rruga më e shkurtër, por është një humbje.

*Dënimi krijon gjithmonë emocione të pakëndshme dhe zemërim si nga ai që e jep, dhe nga ai që e merr.*

*Është më mirë të përqendrohesh më shumë tek lavdërimi sesa tek dënimi.*

## **Ironia**

Një tjetër tip dënimi është përqeshja, ngacmimi, ironia, sarkazma. Ky lloj dënimi nuk duhet kurrë të përdoret, për asnjë arsye.

Ndër të gjitha është më i rrezikshmi dhe më i dëmshmi: dëmton përfundimisht autostimën që është forca e tretë thelbësore e rritjes (dy të tjerat janë: forca fizike dhe miratimi i personave të rëndësishëm për fëmijën).

Duam të jemi të qartë: ironia, sarkazma janë dënime që duhen larguar nga mendja pa “nëse” pa “por”; të përdorësh të tilla dënime është papërgjegjshmëri!

E tillë ishte, edhe shembulli, e mësuesit që pasi kishte korrigjuar diktimin e nxënësit, e thërri dhe, përpara të gjithë klasës, i tha: “Marko tani e kuptoj përse je kaq i shëndoshë: ti kullufit edhe të gjitha shqiptimet!”.

Shokët qeshën, Marko u ndje i ofenduar, i nervozuar.

Jo, kështu nuk shkon!

Ashtu si nuk shkon me denigrimin (një mënyrë dënimi shumë e ngjashme me përqeshjen).

Tregon Stefano (9 vjeç): “Dje isha në dhomën time që luaja në kompjuter. Vjen mamaja ime dhe më thotë të shkoja dhe të bëja për të ngrënë. Unë, shumë i kënaqur, vrapova në kuzhinë, dhe kështu fillova të mishin steka dhe e vura ta skuqja në tigan. Vendosa një biftek në vajin e nxehtë, por meqë e lashë të binte shpejt, vaji spërkati përreth dhe ja mamaja ime filloi të bërtiste: “Shko, shko! Di vetëm të bësh rrëmujë”. Unë i thashë: “Të gjithë mund të gabojmë” dhe u ktheva në dhomën time i nevrikosur”.

Ja një dënim i gabuar! Ulërime e mamasë: “Ik largohu! Di vetëm të bësh rrëmujë!”.

Janë fjalë që, edhe për një fëmijë, janë më të rënda sesa një shuplakë!

Këto ishin për Stefanin tonë.

### ***Të japësh një shuplakë është gjithmonë një humbje!***

***Fëmijët kanë ndjenjë të thellë të drejtësisë dhe do të të duan prapë e shumë nëse dënimi ka qenë i drejtë***

### ***Privimi nga komoditetet dhe kënaqësitë***

Tipi i tretë i dënimeve është privimi nga komoditetet dhe kënaqësitë.

“Nuk je sjellë mirë! Sot nuk ka patatina!”. “Je zënë me vëllain. Këtë mbrëmje nuk ke për të parë televizor!”.

Përdorimi i këtij dënimi është i lejuar, sepse përveç se e lajmëron për gabimin e bërë, kërkon edhe sakrificë.

Tani, dihet, sakrifica është palestra e vullnetit.

Prandaj është e nevojshme përdorimi veçanërisht, në kohët e sotme, tipi i dënimit që jemi duke folur.

Është e qartë që privimet duhet të jenë të mençura dhe të përdorshme, në mënyrë që të mos rezultojnë të dëmshme as në trup dhe as nga ana psikike të fëmijës.

Ti ndalosh, për shembull, të shkojë të luajë në oborr ose të shohë një film të bukur për të cilën do të flitet nesër në shkollë, është e papranueshme.

***“Mësuesi të përpiqet të jetë i dashur,***

***nëse dëshiron t'ia kenë frikën***.  
(Don Bosco, edukator: 1815-1888)

### ***Dënimi moral***

Tipi i katërt i dënimit është ajo e quajtur “dënimi moral”. Një tip dënimi për tu marrë në konsideratë. Konsiston në të shfaqurit e trishtuar, të pakënaqur nga diçka që ka ndodhur.

Është dënimi moral mos i flit më djalit për një farë kohe: “Ke thënë shumë gënjeshtër! Nuk kam më dëshirë të flasë me ty!”

Është dënimi moral të jesh i zemëruar (të varësh turinjtë). Thoshte politikani Giulio Andreotti: “turivarja është më e mërzitshme sesa shuplaka”.

Dënimi moral është një dënim “fisnik”: nuk njollos duart, nuk bërtet.

Dënimi moral në përgjithësi funksionon, veçanërisht me të vegjlit.

Mund të praktikohet në dy kushte:

1. që mungesa e vlerësimit dhe dashurisë të mos zgjasë gjatë (fëmija nuk mund të durojë gjatë kohën të mos ndihet i dashur nga të tjerët!);
2. pasi të ketë bërë dënimin, fëmija duhet të rehabilitohet, të ndjehet i dashur dhe i vlerësuar.

### ***Dënimi si pasojë natyrore e të bërit keq***

Më në fund kemi tipin e pestë të dënimit: ajo që vjen si pasojë natyrore të të keqes që ke bërë.

“Ke dashur të hash shumë ëmbëlsia? Tani ke dhimbje barku!”. “Nuk ke dashur të mbulolesh? Tani ke temperaturë!”. “Ke thyer xhamat? Tani rri në të ftohtë!”...

Është e natyrshme që një tip i tillë dënimi është e praktikueshme vetëm nëse eksperiencia nuk shumë e rrezikshme. Në këtë rast nuk do të mund të thojë: “Ke dëshiruar të notosh kur nuk di not? Tani mbytu!”.

Megjithatë dënimi si pasojë natyrore e një çrregullimi ka avantazhe të mëdha mbi të gjitha tipet e dënimit: është i menjëhershëm, është objektiv, është e njëjtë për të gjithë, është i aftë për orientim mbi atë çfarë bën.

Për këtë është e zbatueshme në kushte që mos ketë pasoja shumë të rënda dhe të riparueshme.

***“Prindërit shumë të butë(permissivë) janë ata që bëjnë padrejtësitë më të mëdha tek fëmijët”***

## **Arti i dënimit**

Na mbetet një pyetje e fundit mbi dënimin: si duhet të veprojmë për të dhënë dënimin që të arrijmë në përfundim edukativ dhe jo ndërshkues.

Ja propozimet tona (të thjeshta për tu komunikuar, të vështira për t'u praktikuar)

### ***Të dënojmë me qetësi***

Gandi i madh (1869-1948) thoshte: “Kur humbet qetësia, humbet vërtetësia”.

Tregimtari amerikan Ambroise Bierce (1842-1914) konfirmon: “Flit kur je i acaruar dhe do të bësh diskutimin më të bukur për të cilin do të pendohesh përgjithmonë”.

Impulsiviteti të verbon. Urrejtja të bën të humbësh ekuilibrin. Si përfundim, të dënojmë pa humbur qetësinë!

Është e vërtetë, e përsërisim: jo gjithmonë është e lehtë.

Përfundojmë me shkrimtaren komike Luciana Littizzetto: “Në vitet e mësimdhënies kam parë sesi me disa djem mund të humbja arsyen!”

Të rinjtë nuk janë ëngjëj, natyrisht. Ndonjerë, në të vërtetë duket që kanë ëndje për të nervozuar dikë që merr flakë shpejt.

Gjithçka është e vërtetë, por i rrituri duhet të jetë më i mençur se të rinjtë: nuk duhet t’ju japi atyre fuqinë që ta bëjnë të ndihet si kafshë e tërbuar e të bëhet agresiv!

### ***Dënojmë më rrallë***

Dënimi duhet të jetë i përkohshëm. Nëse është shumë i shpeshtë, humb efikasitetin.

Njeriu është një qenie që ambientohet me gjithçka: ambientohet deri edhe të të shikojë të vdesësh.

Të mendojmë se nuk do të ambientohet, për shembull, me të bërtiturën. Mësuesi që bërtet vazhdimisht lodhet kot: asnjë nuk do ta dëgjojë më.

E njëjta gjë ndodh me dënimin: nëse nuk është i rrallë, humbet efikasitetin, nuk arrin qëllimin tënd: për ta bërë të vetëdijshëm për gabimin që ka bërë.

Nëse dënimi është shumë i shpeshtë, fëmija mund të arrijë të mendojë që profesioni i prindit është ajo e të dënuarit, si profesioni i bukëpjekësit që bën çdo ditë të njëjtën bukë.

### ***Të dënojmë shpejt***

Po, është mirë që dënimi të jetë i menjëhershëm pas dënimit që fëmija ka bërë. Pra mamaja nuk thotë, p.sh. të voglit: “Prit këtë mbrëmje kur të vijë babai!”.

Përveç imazhit jo simpatik që fëmija mund të ketë për babain si dënues, është e mundur që fëmija nuk dallon dënimin të dhënë tani, në mbrëmje, me sjelljen e tij të gabuar të mëngjesit.

***“Atë ditë (fëmija ishte 8 vjeç!)***

***kuptoi që duhet të ndalojë duke adhuruar fëmijën; duhet të fillonte ta edukonte!”.***

***(Penelope Leach, shkrimtare dhe pediatre angleze)***

### ***Të dënojmë me inteligjencë***

Ndoshta është kjo mënyra më e rëndësishme e artit të të dënuarit: dënimi duhet të jetë i proporcional në lidhje me dënimin e bërë!

Nuk do të ishte inteligjente, p.sh. të dënosh rreptë fëmijën sepse nuk ka larë mirë duart dhe ta ndalosh për diçka sepse nuk ka lënë të qetë motrën.

Dënojmë me inteligjencë kur dënimi ndriçon fëmijën: e bën të kuptojë që është një shkallë Vlerash që nuk kanë të gjithë të njëjtën peshë, por të gjitha duhet të respektohen në bazë të vendit që zenë në shkallë. Mungesa e respektit të njeriut (të çdo njeriu!), dënohet gjithmonë me masën më të rëndë sepse njeriu është në shkallën më të lartë.

***“Shkelja më e rëndë – ajo që të heq 10 pikë në patentën e prindërve – është rrahja e fëmijëve”.  
(Franco Frabboni, pedagog)***

### ***Të dënojmë duke e motivuar***

Dënimi, vetëm, nuk zgjidh asgjë. Ka efikasitet pedagogjik vetëm nëse është i motivuar dhe i kuptueshëm.

Me “Këtu komandaj unë” dhe “Është kështu sepse kështu është!”, formohen fëmijë të terrorizuar dhe jo të edukuar!

Fëmija, edhe i vogël, duhet të njohë arsyet e dënimit: vetëm kështu ndriçohet dhe mund të kuptojë sepsenë e sjelljes së tij jo të mirë.

“Nuk ke pasur dëshirë të mbledhësh letrat që ke hedhur në tokë, kështu unë nuk kam dëshirë të të marr në krahë!”. “Ke qëndruar shumë kohë kot para se të filloje detyrat, dhe unë do të pres për të të dhënë mbasditen, ose për të pregatitur darkën...”.

Jo, nuk janë shantazh, por argumente te kuptueshme për fëmijën Argumente që bëjnë të mendojnë të vegjlit që dënimi nuk është biri i forcës, por i arsyes.

Është e qartë që në moshën preadoleshence dhe adoleshente, motivimet duhet të jenë më racionale dhe të thella.

Droga, për shembull, është e dënueshme sepse të drogohesh është të braktisesh, është të vetëshkatërrohesh...

### ***Të evitojmë që të lindin raste dënimi***

Ndoshta nuk është e gabuar të mbështesësh që 70% e sjelljes së fëmijës që bëjnë të lindin në ne mendime për të mbështetur dënimin, lindin për fajin tonë!

Lindin, p.sh., nga karakteri ynë i tensionuar, i lëkundur, i shqetësuar, bërë posaçërisht për të nervozuar fëmijët dhe për ta bërë më kapriçioz.

Lindin (është një tjetër shembull) nga fakti që e detyrojmë fëmijën të jetojë në një ambjent që nuk është i përshtatshëm për fëmijën.

Sot shtëpitë janë bërë në mënyrë të tillë që është gjithçka e mundshme që fëmija të mos gabojë!

Mobiljen bëhen pis, pllakat gërvishten, muret bëhen me njolla... Fëmijët do të ishin dënuar shumë për të qenë të mirë!

Kishte të drejtë pediatri më i dëgjuar i shekullit të kaluar Marcello Bernardi (1922-2001) për të paralajmëruar prindërit: “Nguliteni mirë që fëmijët tuaj janë duke u përballur me një ndeshje gati të dëshpëruar! Nuk ka asgjë ose pothuajse asgjë që shkon mirë për fëmijët në këtë botën e sotme”.

### ***Të mbyllim me aq***

Më në fund, pasi keni dhënë dënimin, mos flisni më!

Asgjë nuk është më antipatike për një fëmijë, për një të ri, që të kenë prindër që çdo mbrëmje iu flasin për gabimet e tyre.

Të tillë prindër bëjnë që fëmijët të mendojnë që të bëhesh ‘i madh’ do të thotë të bëhesh i mërzitshëm! Ideja që nga ndan nga fëmijët të cilët me mençuri mendojnë që jeta është për t’u jetuar, jo për t’u mërzitur.

*“Një kalë i padisiplinuar bëhet hezitues, një fëmijë i lënë pas dore bëhet i papërmbytshëm”*

## Një detyrim

“Të dënosh” nuk është folja më e rëndësishme në artin e të edukuarit.

Më të rëndësishëm janë folje të tjera, si ‘flas’, ‘dua’, shndrit’.

‘Të flasësh’, sepse të edukosh janë faktorë të brendshëm: të edukosh është ta bindësh. Tani, vetëm fjala bind. Armët (dhe dënimi është një armë!) mund të fitojë, por jo të bindë.

‘Të duash’, sepse influenza jonë arrin ku arrin dashuria jonë.

‘Të shndrisë’, sepse të edukosh nuk është të ngjitesh, por është të marrësh një ndjenjë. Të edukosh është të jesh çfarë dëshiron të transmetosh: të edukosh është të shndrisësh.

Gjithçka është e vërtetë, por dënimi ka edhe një anë të tij (edhe pse në plan të dytë) për të formuar një njeri të ri.

Për këtë do të ishte e dëmshme ta lëshë mënjatë.

Dënimi i drejtë është aleati ynë për të formuar një fëmijë të mirë, të qetë, të fortë: një fëmijë i përgatitur për të mos shkatërruar jetën e tij.

Për këtë ishte detyra jonë për të folur, si për edukatorin është detyrë për t’u informuar.